



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 705 Prot.

Tiranë, më datë 02.07.2020

VENDIM
Nr. 190, datë 09.06.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 09.06.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit kërkimor-shkencor në vazhdim « **Topografia Epidamne-Dyrrhacion, Durrës** » drejtuar nga Prof. Asoc. Eduard Shehi, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga IA në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Sondazhe tek Forumi bizantin, tek hyrja verilindore e monumentit dhe jashtë murit periferik të tij;
 - Sondazhe në oborrin e një banese pronë e Kishës Katolike ngjitur me fortifikimin jugperëndimor, ekstra muros, mes kullave D dhe E;
 - Studime gjeofizike me pajisje radar elektro-magnetik në qendrën e qytetit të Durrësit (në një hapësirë që përfshinë territorin nga fortifikimet juglindore – amfiteatrin – bashkinë – xhaminë – sheshin Liria dhe rrugët që të çojnë drejt tij;
 - Shpimet e para gjeologjike për të studiuar evolucionin morfologjik të territorit dhe raportin mes tokës së thatë dhe sipërfaqeve ujore (det, lagunë, kënetë).
 2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brënda vitit 2020;
 3. Në rastet kur parashikohen ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre, dhe të shoqërohen me projekt konsolidimi/konservimi/restaurimi pranë IKTK;
 4. Të depozitohen pranë IKTK-së, DRTK-së dhe IKRTK-së lista e inventarit të gjetjeve me qëllim grumbullimin, informimin/ regjistrimin sipas rastit dhe ekspozimin e tyre në Muze;
 5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
 6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

